

E nderuar familja Daci

Të nderuar akademikë

Të nderuar miq, bashkëpunëtorë dhe të gjithë të pranishëm

Në fillim të këtij viti, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës u përball me një lajm të hidhur: ndarjen nga jeta të akademik Nexhat Dacit, njërit ndër personalitetet e shquara të jetës akademike, shkencore dhe institucionale të vendit tonë.

Në këto çaste përkujtimi, në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ju ftoj që me një minutë heshtje të nderojmë emrin, jetën, veprën dhe personalitetin e akademik Dacit.

*I përjetshëm qoftë kujtimi për akademik Nexhat Dacin*

*Lavdi jetës dhe veprës së tij.*

Sot jemi mbledhur këtu për të shprehur nderimin dhe mirënjohjen tonë të thellë për jetën, veprën dhe kontributin e tij të çmuar. Akademik Nexhat Daci ishte një figurë e përkushtuar e dijes, një intelektual i palodhur dhe një udhëheqës me vizion, i cili me veprimtarinë e tij la gjurmë në zhvillimin e shkencës, arsimit dhe institucioneve akademike në Kosovë.

Akademik Daci ishte profesor në Universitetin e Prishtinës, specialist i spikatur në fushën e Kimisë, veçanërisht në disiplinat e kimisë organike, mjedisit jetësor dhe metodologjisë e teknikave kërkimore të resurseve natyrore të Kosovës. Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Kryetar i saj në një periudhë të rëndësishme të zhvillimit institucional.

Ai përfaqëson brezin e intelektualëve që, përmes dijes dhe autoritetit akademik kontribuan në ndërtimin e themeleve të shtetit të institucioneve të tij.

Kontributi i tij nuk kufizohet vetëm në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, por shtrihet edhe në ndërtimin dhe forcimin e institucioneve akademike, në përfaqësimin dinjitoz të dijes kosovare dhe në edukimin e brezave të rinj studiuesish.

Vepra dhe përkushtimi i tij do të mbeten referencë dhe frymëzim për komunitetin akademik dhe më gjerë. Në jetën publike dhe shtetërore, akademik Nexhat Daci ushtroi detyrën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, në një kohë vendimtare për konsolidimin e rendit kushtetues dhe demokratik.

Me përgjegjësi institucionale dhe respekt ndaj parimeve të shtetit ligjor, ai dha kontribut në funksionimin e institucioneve përfaqësuese dhe në afrimin e Kosovës në rrafshin institucional. Mirësia, toleranca dhe njerëzia ishin veçori të dalluara të Akademik Dacit, sikundër dhe raportet e tij me kolegët e bashkëpunëtorët, duke respektuar çdo mendim të tjetrit, ishte i përshtatshëm për bashkëpunim dhe i gatshëm në çdo moment që të ofronte ndihmë për secilin atje ku ishte e mundur.

Si kryetare aktuale e Akademisë së Shkencave dhe Artave të Kosovës, shpreh vlerësimin më të lartë institucional për rolin dhe kontributin e tij në drejtimin e Akademisë dhe në avancimin e mendimit shkencor dhe akademik në vend. Veprimtaria e tij akademike dhe institucionale mbetet pjesë e historisë sonë të përbashkët dhe e trashëgimisë akademike të Kosovës.

Në emën të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si Institucion kombëtar i dijes dhe i kulturës, dhe në emrin tim personal, i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Daci, miqve, bashkëpunëtorëve, shokëve të tij të shumtë nga gjithë Kosova e bota shqiptare, dhe gjithë atyre që e çmuan dhe e respektuan veprën e tij.

Akademike Justina Shiroka Pula